



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 4, datë 06.02.2024

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 49, DATË 31.05.2022 PËRSA I PËRKET Z. KUJTIM CANI, NR. 35, DATË 31.03.2021 PËRSA I PËRKET Z. BLERIM DACI, NR. 187, DATË 22.12.2023 PËRSA I PËRKET ZNJ. FATBARDHA GJOLI, NR. 72, DATË 20.07.2020 PËRSA I PËRKET Z. ASTRIT JONUZ HOXHA, NR. 34, DATË 03.02.2023 PËRSA I PËRKET Z. ROMEO UZUNI DHE ZNJ. FATBARDHA UZUNI, NR. 107, DATË 19.10.2022 PËRSA I PËRKET Z. ARBEN LIMAN GJOKA, NR. 104, DATË 30.10.2020 PËRSA I PËRKET Z. AHMET RAMADAN XHURXHI

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 53, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i Njesisë Administrative si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfituar nga Programet e Rindërtimit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 49, datë 31.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njesisë Administrative nr. 2, Rruga “Isuf Molla”, Pallati nr. 27 i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e

tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 31.03.2021 “Për miratimin e listës së parë paraprake të 60 familjeve që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes dhe do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 187, datë 22.12.2023 “Për miratimin e disa shtesave në aneksin 1, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 145, datë 28.09.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 3, Rruga “Hysen Myshketa”, pallati nr. 30, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 72, datë 20.07.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 34, datë 03.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Procesit të Rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, rruga “Ahmet Ademi”, pallati nr. 6, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 107, datë 19.10.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 5, 6, Rrashbull, Katund i Ri dhe Manëz, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 104, datë 30.10.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit/rikonstruksionit në Njësitë Administrative nr. 1,2,4,5,6, Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Ishëm dhe Manëz, Bashkia Durrës” si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 49, datë 31.05.2022 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Kujtim Cani në masën e strukturës së njësisë së banimit 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
2. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 31.03.2021 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Blerim Daci në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 187, datë 22.12.2023 përsa i përket klasifikimit si përfitues të znj. Fatbardha Gjoli në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
4. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 72, datë 20.07.2020 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Astrit Jonuz Hoxha në listën e përfituesve në masën e

strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.

5. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 34, datë 03.02.2023 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Romeo Uzuni dhe znj. Fatbardha Uzuni në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
6. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 107, datë 19.10.2022 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Arben Liman Gjoka në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
7. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 104, datë 30.10.2020 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Ahmet Ramadan Xhurxhi në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani-Dyrmishi



U shpall sot me datë 07.02.2024



BASHKIA DURRËS

15.02.24 Nr.1492/3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 97 / prot.
4Durrës, më 15.02.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.4 datë 06.02.2024 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve ne VKB Nr 49 dt 31.05.2022 përsa i përket Z.Kujtim Cani, Nr 35 dt 31.03.2021 përsa i përket Z.Blerim Daci, Nr 187 dt 22.12.2023 përsa i përket Znj. Fatbardha Gjoli, Nr 72 dt 20.07.2020 përsa i përket Z.Astrit Jonuz Hoxha, Nr 34 dt 03.02.2023 përsa i përket Z.,Romeo Uzuni dhe Znj. Fatbardha Uzuni, Nr 107 dt 19.10.2022 përsa i përket Z. Arben Liman Gjoka, Nr 104 dt 30.10.2020 përsa i përket Z.Ahmet Ramadan Xhurxhi”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**